

Gruas Kosovare

Përmbajtja

- 2 SHE - ERA Publikon Raportin mbi Gratë Femëre
- 2 Kërkohe Pjesëmarrja e Grave në Negociata
- 2 Shënime nga Takimi i Prillit
- 3 Safete Rogova - Artistja me Shpirt Aktivisteje
- 3 Aktivistet Dorëzuan Raportin mbi RKSOKB 1325
- 3 Prezantimi i Shërbimit Policor të Kosovës
- 3 Përfshirja e Grave në Ndërtimin e Demokracisë
- 3 Anëtarët Finalizojnë Kodin e Mirësjelljes
- 4 Shoqëria Civile Dërgon letër Ahtisaarit

Njohtimet

Takimi i RRGK-së.....
...ATRC, 11:00, 4 Shtator

RRJETI I GRUPEVE TË
GRAVE TË KOSOVËS



KOSOVA WOMENS
NETWORK

www.womensnetwork.org

Gratë nga Kosova dhe Serbia Deklarojnë së Bashku

Rrjeti i Grupeve të Grave në Kosovë dhe Rrjeti i Grave në të Zeza nga Serbia, krijuan Koalicionin e Grave për Paqe (KGP) më 7 maj; misioni i tyre është të fuqizojnë një koalicion të përbashkët i cili ngritë vizibilitetin e perspektivave femërore mbi çështjet politike në Serbi dhe Kosovë.

Në veprimin e tyre të parë më të rëndësishëm, KGP lëshoi një deklaratë për ekipet negociatore duke avokuar për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Serbi dhe Kosovë. KGP theksoi nevojën e identifikimit dhe mbrojtjen të pasurisë kulturore siç janë kishat, xhamitë dhe katedralet nga degradimi fizik dhe eksploatimi politik. Në deklaratën e tyre, KGP thotë, "...pasuria kulturore është e lidhur me trashëgiminë kulturore, historinë dhe zotimet e të gjitha grupeve etnike, dhe rrjedhimisht të gjitha grupet etnike kanë të drejtë të shfrytëzojnë bashkërisht, mbrojnë dhe ruajnë këto pasuri të trashëguara."

Duke luftuar për një paqe të qëndrueshme, KGP punon për përfshirjen e grave në proceset e ndërtimit të paqes, si partnerë të

barabartë. Është iniciativë qytetare e bazuar në solidaritetin e grave të cilat tejkalojnë dallimet etnike dhe fetare, si dhe barrierat e kufijve. Duke punuar për së afërmi me Fondin Zhvillimor të Grave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNIFEM), KGP thekson se do të ndjekë parimet vijuese themelore:

o Fuqizimin e koalicionit.
o Veprime konkrete në nivelin lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.
o Ngritjen e vizibilitetit të perspektivave të grave përmes

veprimeve të ndërmarra nga koalicioni, posaçërisht në nivelin ndërkombëtar.

o Këmbimin i dyanshëm i informatave (mes Serbisë dhe Kosovës) lidhur me zhvillimet politike.

o Këmbimin i dyanshëm të përvojave mbi hulumtimet krahasuese.

Takimi i ardhshëm i KGP do të mbahet në qershor, në Beograd. Takimi do të fokusohet në punën e ardhshme të përbashkët mes KGP dhe UNIFEM.



Përfaqësueset e Gratë në të Zeza, RRGK dhe UNIFEM u takuan në Prishtinë më 7 maj për të bërë strategjinë mbi planet e Koalicionit të Grave për Paqe.

RRGGK dhe LGK shtynë UNMIK-un të Kërkojë Falje

Deklaratat dhe publikimet në media të bëra nga RRGK dhe Lobi i Gruas Kosovare (LGK) shpejtë deri tek dënimi i faktorit ndërkombëtar kundër dhunës së zbatuar nga ana policisë së UNMIK-it ndaj popullatës së Krushës së Vogël. Tentativat e pareshtura të RRGK dhe LGK nxitën UNMIK-un që të kërkojë falje si dhe deputetët e kuvendit që të dënojnë dhunën policore.

Më 25 maj 2006, një konvoj i policisë së UNMIK-it që transportonte ish banorët serb të Krushës së Vogël, arriti në fshat i paparalajmëruar. Kur policia e UNMIK-it refuzoi kërkesën e grave lokale që të bisedojnë me ish-banorët, gratë bllokuan hyr-

jen e konvojit në fshat. Si reagon, policia e UNMIK-it largoi me dhunë gratë nga rruga, duke shfrytëzuar shufrat e gomës dhe gaz lotsjellës. Gratë iu kundërpërgjigjën kësaj me gurë, dhe konvoi u largua duke hedhur gaz lotsjellës kundër grave dhe fëmijëve gjatë largimit nga fshati. Tre burra dhe 33 gra kërkuar kujdes mjekësor dhe 22 fëmijë u trajtuan për dëmtimet e marra nga gazi lotsjellës.

Përfaqësuesja e RRGK mbledhi deklaratat nga qytetarët disa orë pas incidentit. Këto deklarata zbuluan të vërtetën pas raporteve zyrtare të policisë së UNMIK-it dhe deklaratave të qeverisjes lokale, të cilat këtë

dhunë e klasifikuan si 'incident ndër - etnik'.

Qytetarët theksuan se ata reagon kundër dhunës së ushtruar nga policia e UNMIK-it dhe jo kundër serbëve. Pas kësaj UNMIK-u lëshoi deklaratat në të cilat dënohej dhuna policore dhe fakti që ata nuk i lajmëruan institucionet lokale mbi këtë vizitë. Ky avokim arriti deri tek nivelet më të larta të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe RRGK morri reagimet nga aktivistët dhe organizatat anëmbanë botës. Për të gjetur tekstin e plotë të deklaratave dhe publikimeve për shtyp, luteni të vizitoni:

www.womensnetwork.org.

Shënime nga takimi i Prillit

Drejtoresha Ekzekutive e RRGK filloi takimin duke i cekur veprimtarinë e anëtarëve lidhur me përfshirjen e femrave në negociatat për statusin final të Kosovës. (për më shumë informata, shih http://www.womensnetwork.org/shqip/raporti_k_s.htm)

Allianca për Biznes e Kosovës dhe Oda Ekonomike janë duke e krijuar një mekanizëm vendor këshillues për të kontribuar në Visionin dhe Planin Zhvillimor për Kosovën 2020. Këta mekanizma do të përfshijnë edhe ekspertizë nga organizatat anëtare të RRGK.

Sherbimi Policor i Kosovës prezantoi Strukturën e reja Gjimore për përmirësimin e rrjedhës së çështjeve gjimore brenda SHPK-së, që filluan së funksionuari në prill të vitit 2006.

Mjekët e Botës, SHBA, prezantoi projektin e tyre 'Qendra mirëqenien e grave', që do të hapet në Prishtinë këtë shtator. Klinika gjinekologjike do të ofrojë ekzaminime mjekësore, teste laboratorike, psikologjike dhe shërbime tjera mjekësore.

Kvinna till Kvinna njoftoi se OSBE është duke bashkëpunuar me UNDO për të organizuar një seri takimesh anëtarëve të Kosovës për të diskutuar sigurinë, ekonominë, dhunën familjare dhe çështjet shëndetësore në Kosovë.

Zyra për Barazi Gjimore ka kërkuar nga Kryeministri që të organizojë takime të rregullta me shoqërinë civile.

Në fund të takimit, RRGK falënderoi prezantuesit dhe shprehu entuziazëm për bashkëpunim të vazhdueshëm mes anëtarëve të RRGK dhe organizatave partnere.

SHE - ERA Publikon Raportin mbi Gratë Fermere

SHE-ERA, anëtare e RRGK e përkushtuar për fuqizimin ekonomik të gruas, publikoi një raport më 4 maj të titulluar "Analizat gjimore të buxhetit dhe varfërinë e grave rurale". Raporti detajon nevojat me të cilat përballen gratë rurale që nuk janë të përfshira në krijimin e politikave dhe ndikimi i kësaj mospërfshirje në popullatë. Në raport sigurohen rekomandime për dizajnim dhe zbatim me të balancuar gjinor të politikave në nivelin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Përfundimisht, SHE-ERA shpreson që rekomandimet do të rrisin mundësitë ekonomike për gratë rurale, si dhe fuqizimin e tyre për të tejkaluar varfërinë.

Raporti identifikon lëvizjet e

dukshme drejt fuqizimit ekonomik të grave, si dhe nevojat e shumta të cilat nuk janë adresuar. Bazuar në këtë hulumtim, SHE-ERA propozoi fushat kyçe përfshirje më të mirë të grave rurale në proceset vendim-marrëse. Për shembull, edhe pse qeveria mban takime të rregullta në të cilat diskuton programet, këto takime nuk kanë nxitur ndonjë dallim i dukshëm dhe nuk kanë përfshirë gratë rurale. Si kontrast, takimet në komuna përfshijnë qytetarët që të hapin debate lidhur me zhvillimin dhe planifikimin e buxhetit.

SHE-ERA gjithashtu vërejt se pikat mbledhëse për prodhimet e fermave ndihmojnë pjesëmarrjen e grave në zhvillimin ekonomik. Rekomandimet për vazhdimin e këtij programi përfshijnë theme-

limin e pikave të mbledhjes për qumësht dhe qasje të ngritur të grave fermere tek frigoriferët. Raporti rekomandon një hulumtim të thuktë për sa i përket sfidave me të cilat ballafaqohen gratë fermere si dhe një plan afatgjatë të qëndrueshëm për gjashtë komunitetet fermere të Gjakovës. Ky plan do të duhej të përfshijë një kanal të ujitjes, të financuar bashkërisht, u theksua nga ta.

SHE-ERA bashkëpunoi me qeverinë lokale, OJQ-të, UNIFEM-in, bankat, institutet për mikro-financim dhe mediat për të shpërndarë raportin në Kosovë dhe jashtë saj. Raporti i SHE-ERA dhe potenciali për krijimin e një nën-agjencie të UNDP për zbatimin e rekomandimeve në aspekt afatgjatë u diskutuan në takimin e 19 majit.

Qytetarët Kërkojnë Pjesëmarrjen e Grave në Negociata



Gratë dhe burrat u mbledhën me 8 mars para Teatrit Kombëtar, në Prishtinë, për të kërkuar pjesëmarrjen e grave në negociata.

Me 8 mars, RRGK dhe LGK organizuan një demonstratë për të thënë, 'ne duam pushtet, nuk na nevojiten lulet' para teatrit kombëtar në Prishtinë. Këngëtarë dhe aktorë të njohur Kosovar u paraqitën me këngët dhe skeçet e tyre të përgatitura enkas për këtë ngjarje, të cilat fokusoheshin në Rezolutën

1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe në rëndësinë e përfshirjes së femrave në bisedimet që kanë të bëjnë me statusin final politik të Kosovës. Kalimtarëve iu shpërndanë materiale të shtypura lidhur me RKSOKB 1325. RTV21 emitoi një program 10-minutësh i cili

dokumentoi tentativat dhe demonstratat anëtarëve të botës për të avokuar për përfshirje më të mirë të femrave në vendim-marrje. Duke theksuar demonstratën e RRGK dhe LGK, RTV21 emitoi një program special gjysmë orësh mbi Rezolutën 1325 të KSOKB. Pas përfundimit të ngjarjes, pjesëmarrësit vendosën jashtë Kuvendit të Kosovës një pamflet në të cilin shkruante "Rezoluta 1325 na garanton të drejtën e pjesëmarrjes në bisedimet për statusin përfundimtar". Ai vazhdon të qëndrojë i varur, në mënyrë që të gjithë qytetarët dhe politikanët ta shohin. UNIFEM e përkrahu këtë aktivitet.

Gjatë përgatitjeve për këtë protestë, aktivistët Kosovare dhe organizatat vendore përpiluan një letër të cilën ia dërguan vendim-marrësve vendor dhe ndërkombëtar, përmes së cilës kërkonin përfshirjen e femrave në ekipin që është duke negociuar lidhur me statusin përfundimtar politik të Kosovës. Kjo letër e cila u lexua edhe në protestë, iu dërgua: të deleguarit special për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës Martti Ahtisaari; Këshillit të Sigurimit të OKB, PSSP Søren Jessen-Petersen; Presidentit Fatmir Sejdiu; Kryeministrit Agim Çeku; Komandantit të KFOR-it Giuseppe Valotto, ekipit negociator dhe të tjerëve. Politikanet dhe OJQ-të nga Shqipëria gjithashtu dërguan letra përkrahëse.

Safete Rogova - Artistja me Shpirt Aktivisteje

Safete Rogova është padyshim njëra prej aktoreve të shquara, aktore e një gjenerate që i dha shkëlqim teatrit dhe skenës kosovare, aktore e rrallë dhe punëtore e rrallë.

Më 1968, u angazhua në Teatrin Popullor të Prishtinës si aktore profesionale. Angazhimi i saj në këtë teatër solli një frymë të re, pasuroi skenën me më se 100 role, një galeri e tërë personazhesh lidhen si një pe i gjatë në bagazhin e saj artistic, role të mëdha e të vogla, personazhe positive e negative.

Safete Rogova përpos angazhimit në lëmin e skenës, bashkë motrën Igballe Rogova dhe të shoqin skenografin Nuredin Loxha (tashmë të ndjerë), themeluan shoqatën "Motrat Qiriaz" aktivitetet e së cilës, veçanërisht vite e fundit, kanë qenë të gjithanshme.

Periudha e gjatë e proklamuar me arritje gjithfarëshe për arsimimin e femrës, për emancipimin e femrës shqiptare në sistemin hegjemonist nuk që i sigurtë, sepse në të

vërtet ajo, gruaja, femra shqiptare po stagnonte në ecje, në zhvillim, në afirmim. Një gjë e tillë që praktikë e përhershme për zonat ku sot e gjithë ditën konsiderohen sit ë skajshme, të lëna pas dore, të harruara. A nuk ishin të tilla zonat e Hasit, Drenicës e Anamoravës, e Shalës, e Buzëdrinit...? Shoqata për arsimimin e gruas "Motrat Qiriaz" i kishte vënë sot e dhjetë vjet të shkuara një detyrë vetes, në programin e saj, në statusin e organizimeve të tilla kudo në botë: të arrinte atje ku e donte çasti, çasti vendimtar, për t'u ardhur në ndihmë nënave shqiptare, motrave shqiptare, atyre që për momentin po përjetonin harresën kolektive.

Vitet e rezistencës së madhe kolektive e kombëtare u pasuruan me një aktivitet largpamës të shoqatës "Motrat Qiriaz", e cila sensibilizoi të drejtën e gruas për të qenë e barabartë, për të pasur iniciativa creative drejt së ardhmes së saj, për të qenë më këmbën-



Safete Rogova në rolin e Mrikës, në shfaqjen "Besa e Madhe" në vitin 1978.

gulse në organizimin e familjes, në afirmimin e vlerave të saj madje edhe në relacione ndërkombëtare.

Sigurisht se të gjitha veprimtarët e shoqatës "Motrat Qiriaz" para dhe pas luftës u ndodhën me ato që kishin më së tepërmi nevojë për ndihmë e përkrahje, për kurajo e ngushëllim, për ta pasur dhimbjen më të paktë, duke fisnikëruar jetën e tyre me lexim librash, për arsimim e aktivitete kulturore dhe veprimtari përcjellëse.

Safete Rogova është një shembull i veçantë në të cilin njeriu shkrin njëjtë dashurinë për artin dhe njerëzit. Tek ajo këto janë të kombinuara, ajo përpiqet t'u ndihmojë njerëzve përmes artit, si forma më sublime e shpirtit të njeriut. Vuajtjet, brengat dhe dhimbjet e të tjerëve, ajo arrin t'i zbusë nëpërmjet magjisë së lojës së të aktruarit...

Ajo është një artiste me shpirt human.



Me 8 mars Safete Rogova lexoi letrën dërguar liderëve ndërkombëtar dhe vendor, duke kërkuar pjesëmarrjen e grave në negociatë, në manifestimin publik në Prishtinë.

Aktivistet Dorëzuan Raportin në hije mbi Zbatimin e RKSOKB 1325 tek Organizata e Kombeve të Bashkuara

Më 30 mars, aktivistet dërguan një 'Raport mbi zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara 1325 në Kosovë' tek Organizata e Kombeve të Bashkuara - Nju Jork, në tentativë për të 'informuar OKB-në mbi ngjarjet dhe veprimet e ndërmarra nga organizatat vendore dhe përkrahësit e tyre lidhur me zbatimin e përgjithshëm të RKSOKB 1325 në Kosovë' që nga viti 2001. Aktivistet vendore morën iniciativën për të përpiluar raportin pasi që Misioni i Administratës së Përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë 'nuk vuri re apo shpërfilli iniciativat vendore drejt zbatimit të rezolutës në raportet e veta të dërguara tek Organizata e Kombeve të Bashkuara.' Raporti ka për qëllim të 'përbushë mungesat e informatave.' Për të lexuar tekstin e plotë, shihni: www.womensnetwork.org.

Shërbimi Policor i Kosovës Prezanton Iniciativa për Përmirësimin e Rrjedhës së Çështjeve Gjinore

Gjatë takimit të anëtarësisë së RRGK në prill, këshilltari për çështje gjinore i Shërbimit Policor të Kosovës Z. Hysni Shala prezantoi një program të ri drejt integritit të rrjedhës së çështjeve gjinore në njësitë e të gjitha niveleve të policisë. Njësia për Çështje Gjinore tenton të arrijë përfshirjen e një perspektive gjinore në veprimtarinë e SHPKOsë, përmes komunikimit, veprimtarive përkrahëse dhe përgjegjësisë. SHPK gjithashtu do të organizojë një debat televiziv për të diskutuar dhunën familjare, trafikimin, ose keqtrajtimin e fëmijëve. Ai theksoi rëndësinë e bashkëpunimit mes SHPK-së dhe RRGK.

Gratë duhet të Përfshihen në Ndërtimin e Demokracisë, u thotë RRGK Udhëheqësve Ndërkombëtarë

Më 7 prill në Vienë, gjatë një konference lidhur me çështjet gjinore dhe konfliktet, organizuar nga Austrian Development Agency përfaqësuesja e RRGK diskutoi mbi Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara me udhëheqës ndërkombëtar, përfshirë Elizabeth Rehn, përfaqësuesja e mëparshme për Drejtë të Njeriu dhe Ambasadorin Mette Kongshem, përfaqësuesin Norvegjez në OSBE. RRGK theksoi se zbatimi i rezolutës 1325 është thelbësore për proceset gjithëpërfshirëse demokratike dhe që mospërfshirja e femrave do të rrezikojë stabilitetin e ardhshëm në Kosovë.

Anëtarët Finalizojnë Kodin e Mirësjelljes

Në tentativë të ngritjes së transparencës dhe përmirësimit të cilësisë së punës së vet, RRGK do të zbatojë vullnetarisht 'Kodin e Etikës dhe Përgjegjësisë'. Më 15 maj, anëtarët diskutuan mbi draftin e kodit të mirësjelljes. Pasi që të inkorporohen sugjerimet e tyre dhe të kryhet miratimi nga Bordi, stafi i RRGK do të kryejë vizita tek anëtarët, gjatë të cilave anëtarëve do t'u mundësohet që të shqyrtojnë dhe nënshkruajnë kodin për të vazhduar anëtarësinë në RRGK.

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

www.womensnetwork.org

info@womensnetwork.org

Hajdar Dushi C-2, 11/8

Prishtinë, Kosovë

Stafi i RRGK

Igalle Rogova

Drejtoresh Ekzekutive

igo@womensnetwork.org

Besa Shehu

Menaxhere e Financave

info@womensnetwork.org

Nexhmije Fetahu

Menaxhere e Programit

info@womensnetwork.org

Alba Loxha

Asistente e Informatave

info@womensnetwork.org

Bordi i RRGK

Naxhije Buçinca

Delina Fico

Besim Kajtazi

Marta Prekpalaj

Vjosa Dobruna

Belgjyzare Muharremi

Behar Selimi

"Zëri i Gruas Kosovare" është
shkruar dhe dizajnuar nga
Alba Loxha dhe Barbra Bearden,
me ndihmën e Nicole Farnsworth.

www.womensnetwork.org

Shoqëria Civile Dërgon letër Ahtisaarit

8 mars 2006, Prishtinë

Për: Të Dërguarin Special të KB për Negociatat për Statusin Final të Kosovës Z. Martti Ahtisaari

I nderuari z. Ahtisaari,

Ne i mirëpresim hapat e rëndësishëm të cilët i keni ndërmarrë kohëve të fundit drejt zgjidhjes së statusit final politik të Kosovës. Zgjidhja e statusit final të Kosovës paraqet një çështje vitale për të gjithë Kosovarët, që do t'i jep formë përparimit politik, ekonomik dhe social të vendit tonë. Pasi që ky proces paqësor ka të bëjë me të ardhmen e vendit tonë, ne kërkojmë që edhe gratë të përfshihen në të.

Ne konsiderojmë që gratë kanë të drejtë që në mënyrë aktive dhe kuptimplote të marrin pjesë në bisedimet mbi statusin final. Kjo kërkesë legjitime bazohet fuqimisht në trashëgiminë e pasur të veprimtarive paqësore të grave përgjatë luftës për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, por ajo gjithashtu përkrahët ligjërisht nga Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së mbi gratë, paqen dhe sigurinë.

Përfshirja e grave në proceset paqësore është një nga dispozitat themelore brenda Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e cila është e zbatueshme në Kosovë. Rezoluta "Kërkon nga Shtetet Anëtare të sigurojnë pjesëmarrjen e shtuar të grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në institucionet e nivelit kombëtarë, rajonal dhe ndërkombëtarë, si dhe në mekanizmat për parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve." Ajo gjithashtu "Kërkon nga Sekretari i Përgjithshëm që të zbatojë planin e tij strategjik të veprimtimit (A/49/587), duke kërkuar ngritje në pjesëmarrjen e grave në nivelet vendimmarrëse në proceset paqësore dhe ato të zgjidhjes së konflikteve.

Që nga fillimi i bisedimeve mbi statusin, ne kemi shkruar shumë letra në emër të grave të Kosovës, duke kërkuar që gratë të përfshihen në këtë proces paqësor. Ne gjithashtu e kemi ngritur këtë çështje në një takim që kemi pasur me PSSP-në, Z. Petersen dhe Kryenegociatorin e OKB-së, Z. Ahtisari. Megjithatë, ekipi negociator i themeluar për bisedimet mbi statusin e Kosovës, deri tani, nuk përmban asnjë grua.

Gratë e Kosovës janë të brengosura që zërat e tyre janë injoruar ose marginalizuar si nga udhëheqësia vendore ashtu edhe nga ajo e UNMIK-ut. Dhe kjo ndodhë, përkundër rolit të mrekullueshëm që ato kishin në të kaluarën dhe në të tashmen. Siç dihet, për më se pesëmbëdhjetë vite gratë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë aktorë të rëndësishëm në të gjitha aspektet e përpjekjeve të Kosovës drejt lirisë, demokracisë dhe pavarësisë. Prandaj, gratë duhet të kenë mundësi që të sjellin idetë, përvojën dhe energjinë e tyre në një proces të rëndësishëm të këtillë, i cili do t'i japë formë të ardhmes së tyre, sikur edhe të ardhmeve të pjesës tjetër të shoqërisë

Në pajtim me Rezolutën 1325, dhe si qytetarë të barabartë dhe të lavdërueshëm të Kosovës, Rrjeti i Grave të Kosovës, që përfaqëson 85 organizata të grave nga të gjitha grupet etnike (Serbe, Rome, Ashkalinje, Turke dhe Boshnjake) nga të gjitha viset e Kosovës, Lobi i Grave Kosovare, që përbëhet nga 26 lidere nga të gjitha sektorët, të përkrahur nga organizatat e nënshkruara më poshtë, kërkojnë:

o Përfshirjen e menjëhershme të një përfaqësuesi të grave të Kosovës në ekipin negociator të Kosovës për bisedimet mbi statusin final, në pajtim me Rezolutën 1325 dhe duke marrë parasysh kontributin e jashtëzakonshëm të cilin e kanë dhënë gratë për paqen dhe lirinë e arritur.

Grave duhet t'i jepet mundësia që të marrin pjesë në këtë proces paqësor i cili do të dizajnojë të ardhmen e Kosovës dhe të rajonit. Nëse gratë dhe ekspertiza e tyre përjashtohen, procesi negociues si dhe përfshirja në të gjitha proceset e ardhshme demokratike padyshim do të pësojë dëmtime. Ndërtimi i një paqeje të qëndrueshme përmes partnershipit të të dyja gjinive vë themelin për një të ardhme të ndritur.

Paraprakisht ju falënderojmë për kujdesin që do t'ia kushtoni kësaj letre.

Sinqerisht,

Igalle Rogova, Drejtoresh Ekzekutive Rrjeti i Grave të Kosovës

Lujeta Vuniqi, përfaqësuese, Lobi i Grave të Kosovës

Behxhet Shala, Drejtor Ekzekutiv, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut

Rreze Duli, Drejtoresh Ekzekutive, Qendra për Trajnime dhe Avokim (ATRC)

Bashkim Rrahmani, Drejtor Ekzekutiv Fondacioni për Iniciative Demokratike

Gjithashtu dërguar edhe:

z. Soren Jessen Petersen, PSSP,

z. Fatmir Sejdiu, Kryetar i Kosovës

z. Giuseppe Valotto, Komandant i KFOR-it

z. Philip Goldberg, Shef i Misionit të SHBA-ve

z. Giorgio Mamberto, Shef i Zyrës së Komisionit Europian në Kosovë

z. David Blunt, Shef i Zyres Britaneze

z. Eugen Wollfarth, Shef i Zyres Gjermane

z. Thierry Reynard, Shef i Zyres Franceze

z. Patrick Mura, Shef i Zyres Italiane

dhe të gjithë anëtarëve të grupit negociator.